



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R.nr.535/2024

Në lidhje me njohjen e bashkësive fetare dhe rregullimin e statusit të tyre juridik në përputhje me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër në detyrë
Qeveria e Republikës së Kosovës

Znj. Feride Podvorica, Ushtruese e detyrës së Sekretarit të Kuvendit
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Për dijeni të:

Z. Habit Hajredini, drejtor

Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 4 shtator 2026

QËLLIMI

Ky Opinion ka për qëllim t'i shprehë qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me njohjen e bashkësive fetare, rregullimin e statusit të tyre juridik dhe ushtrimin efektiv të lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë në përputhje me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”
2. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
3. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjerash, përcakton këto kompetenca dhe përgjegjësi për Avokatin e Popullit:
 - “Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16.1).
 - “T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

RRETHANAT E RASTIT

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 3 qershor 2024 ka pranuar ankesë nga Bashkësia e Tarikateve të Kosovës (BTK), të cilën e përfaqëson z. Lulzim Shehu, parashtruar kundër Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për shkak se ASK-ja nuk e ka përfshirë BTK-në si bashkësi fetare të veçantë në pyetësin për regjistrimin e popullsisë.
5. Sipas deklarimeve të përfaqësuesit të BTK-së, me rastin e regjistrimit të popullsisë nga ASK-ja, më 2024, atyre u është mohuar dhe pamundësuar shprehja e lirë e identitetit fetar. Sipas ankuesit, në pyetësin e regjistrimit të popullsisë, i përgatitur nga ASK-ja, nuk ka pasur mundësi që pjesëtarët e kësaj bashkësie ta shprehnin identitetin fetar, ngase në pyetjen nr. 10: “Cili është besimi i juaj fetar?”, përveç opsionit për deklaram të besimit fetar për disa bashkësi të tjera fetare (islam, ortodoks dhe katolik), ka munguar opsioni i deklaramit specifikisht për bashkësitë e tjera fetare, në këtë rast opsioni për ta deklaruar përkatësinë fetare të tarikateve.
6. Më 26 qershor 2024 përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë pranuar në takim përfaqësuesit e BTK-së. Në takim, përfaqësuesit e BTK-së kanë ofruar informata dhe kanë shpalosur shqetësimet e tyre. Sipas tyre, tarikatet janë të pranishme në Kosovë që nga Shekulli XV dhe përfaqësojnë pjesë integrale të etosit¹ të Kosovës. BTK-ja është një

¹ Fjala “etos” është përdorur nga vetë ankuesi e që sipas Cambridge Dictionary do të thotë: the set of beliefs, ideas, etc. about the social behaviour and relationships of a person or group; - tërësia e besimeve, ideve etj. lidhur me sjelljen shoqërore dhe marrëdhëniet e një personi ose grupi.

organizëm ombrellë, që përfaqëson dervishët (myslimanët me tarikat) e Kosovës dhe tarikatet e tyre. Në Kosovë, sipas tyre, aktualisht funksionojnë 9 tarikate: Kaderi, Rufai, Saadi, Nakshibendi, Melami, Sinani, Shazeli, Bektashi dhe Halveti. Bashkësia e Tarikateve në të kaluarën është njohur me emrin përshkrues “Bashkësia e Radhëve të Dervishëve Islam Alije” (BRDIA, ose serbokroatisht ZIDRA). Sufitë (dervishët) ishin përjashtuar nga Bashkësia Islame e Jugosllavisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Që prej atëherë ata janë të organizuar dhe veprojnë në mënyrë të pavarur. Sipas përfaqësuesve, Bashkësia e Tarikateve është themeluar ligjërisht si bashkësi e pavarur fetare më 1974.

7. Shqetësimet kryesore të shpalosura nga BTK-ja janë Ligji i mangët për Liritë Fetare, i cili nuk u jep mundësi regjistrimit të grupeve fetare, pra mungesë e statusit ligjor; çështja e regjistrimit të popullatës dhe mos përfshirja e Bashkësisë Tarikateve të Kosovës në pyetësor; si dhe radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, që është kërcënim i përgjithshëm për komunitetin e tarikateve dhe Kosovën.
8. Më 17 tetor 2024 Avokati i Popullit i ka dërguar shkresë zëvendëskryeshefit ekzekutiv të ASK-së, për ta informuar lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të BTK-së dhe për të kërkuar informacione se cilat kanë qenë kriteret që janë marrë për bazë me rastin e hartimit të pyetësorit për regjistrimin e popullsisë në vitin 2024 për vendosjen në pyetësor të vetëm disa bashkësive fetare.
9. Më 29 janar 2025 Avokati i Popullit i ka dërguar një shkresë rikujtuese kryeshefit ekzekutiv të ASK-së.
10. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje në shkresat dërguar kryeshefit ekzekutiv të ASK-së.
11. Sipas nenit 24, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit: *“Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.”*

SFONDI LIGJOR

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

12. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton lirinë e fesë.

Nenit 8 [Sheti Laik] i Kushtetutës, përcakton se:

“Republika e Kosovës është një shtet laik dhe është neutral në çështjet e besimeve fetare.”

Neni 9 [trashëgimia Kulturore dhe Fetare] i Kushtetutës përcakton se:

“Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së saj kulturore dhe fetare”.

Neni 24 [Barazia para Ligjit], përcakton se:

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 38 [Liria e Besimit, Ndërgjegjes dhe Fesë]

1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.
4. Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.

Neni 39 [Konfesionet Fetare]

1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare dhe monumentet fetare brenda territorit të saj.
2. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.
3. Konfesionet fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligj.

Instrumentet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

13. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton parimin e zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe ofron një listë instrumentesh ndërkombëtare të mbuluara nga ky parim, duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) KEDNJ-në dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP) Në rast konflikti, këto instrumente ndërkombëtare “kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve”.

14. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 9 [Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë] përcakton:

- “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.
2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”

15. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 18, paragrafi 1 dhe 2

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejte përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.

2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.

OPINIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Analiza ligjore

16. Avokati i Popullit vëren se në formularin për regjistrim, pyetja nr. 10 është: “*Cili është besimi i juaj fetar?*” dhe se janë ofruar 6 përgjigje të mundshme: 1. Islam; 2. Ortodoks; 3. Katolik; 4. Tjetër, specifiko; Asnjë Besim Fetar; 6. Preferoj të mos përgjigjem.
17. Fillimisht krijohet përshtypja se opsioni për ta deklaruar besimin fetar mund të jetë pika 4 e formularit. Por, në fakt Rezultatet e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë² nuk përmbajnë të dhëna të disagreguara për pjesëtarët e popullsisë që kanë zgjedhur opsionin numër 4. Nga të dhënat e regjistrimit del se janë 7 175 qytetarë apo 0.45% që kanë zgjedhur opsionin numër 4, por nuk ka të dhëna për besimet e tjera fetare, të cilave këta qytetarë u përkasin apo nuk u përkasin.
18. Çfarë vërehet që në fillim është se kriteri i vendosjes së vetëm tri besimeve religjioze në pyetjen numër 10, në formularin e regjistrimit nuk ka ndonjë bazë as në Ligjin për Lirinë Fetare, për shkak se pyetësi nuk përfshin të gjitha besimet që shprehimisht përmenden në ligj. Vërehet se pyetësi ka lënë jashtë Bashkësinë e Besimit Hebrej dhe Kishën Evangjeliste.
19. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, neni 5, paragrafi 4, përcakton: “*Të gjitha besimeve dhe bashkësive të tyre në Kosovë duke përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebrej, dhe Kishën Evangjeliste, do t’u ofrohet çdo lloj mbrojtjeje dhe mundësi për të gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuara me këtë Ligj.*”
20. Megjithëse ligji specifikon shprehimisht disa besime dhe bashkësi fetare, i njëjti nuk përjashton faktin që në Kosovë ka edhe besime të tjera. Fraza “*të gjitha besimeve dhe bashkësive të tyre në Kosovë duke përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebrej, dhe Kishën Evangjeliste [...]*” shpie në një interpretim që në Kosovë, përveç besimeve që përmenden, ekzistojnë edhe besime të tjera, të cilave ligji u ofron çdo lloj mbrojtjeje dhe mundësi për t’i gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuara me këtë ligj.
21. Udhëheqësit fetarë kanë ngritur vazhdimisht shqetësimin se mungesa e një mekanizmi ligjor për regjistrimin e bashkësive fetare dhe fitimin e statusit të personit juridik ka krijuar vështirësi të konsiderueshme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre të përditshme, përfshirë zotërimin dhe regjistrimin e pronës dhe automjeteve, hapjen e llogarive bankare, si dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore ndaj punonjësve. Si pasojë e mungesës së një kuadri të posaçëm ligjor, bashkësitë fetare janë detyruar të veprojnë në bazë të një kuadri të

² <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf> faqe 46 dhe 47.

pamjaftueshëm, duke u regjistruar si organizata joqeveritare. Pikërisht për të adresuar këtë boshllëk ligjor, më 7 qershor 2010, nëpërmes Raportit me rekomandime *ex-officio* nr.145/2010, në lidhje me mungesën e akteve ligjore për zgjidhjen e pozitës dhe statusit juridik të bashkësive fetare në Kosovë Avokati i Popullit i Kosovës i rekomandoi Kuvendit të Kosovës plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, me qëllim rregullimin e statusit juridik të bashkësive fetare. Sipas Avokatit të Popullit, rregullimi i statusit juridik ishte i domosdoshëm jo vetëm për të garantuar funksionimin normal të bashkësive fetare, por edhe për t'i dhënë fund trajtimit diskriminues ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare në Kosovë.

22. Gjatë viteve 2012-2013, Zyra Ligjore e Kryeministrit përgatiti Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare qëllimi i të cilit ishte të *“rregullojë statusin ligjor të shoqatave fetare, regjistrimin dhe mbylljen e tyre, si dhe disa aspekte financiare që lidhen me aktivitetin e bashkësive fetare në Republikën e Kosovës, në bazë të parimeve ndërkombëtare dhe kushtetuese mbi lirinë e fesë, ndërgjegjes dhe besimit, si dhe neutralitetin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e besimit fetar”*. Mirëpo, deri më tani ky Projektligji nuk arriti të miratohet
23. Komisioni i Venecias ka përgatitur një Opinion³ lidhur ketë Projektligj, ku kishte ngritur çështje serioze lidhur me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit duke vë në pah faktin se projektligji, parashikon regjistrim automatik vetëm për pesë bashkësi fetare, të cilat shprehimisht përmenden në nenin 5, paragrafi 4 të ligjit në fuqi, ndërsa të gjitha bashkësitë e tjera duhet t'i nënshtrohen procedurës së regjistrimit dhe vlerësimit për të fituar personalitetin juridik.
24. Komisioni ka shprehur shqetësimin se kriteri i përdorur në projektligj, që vetëm pesë bashkësitë e përmendura përbëjnë *“trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit”* mund të jetë diskriminues, pasi nënkupton se bashkësitë e tjera nuk janë pjesë e kësaj trashëgimie. Për të shmangur diskriminimin, Komisioni thekson se autoritetet duhet të sigurojnë që edhe bashkësitë e tjera fetare të konsoliduara, të cilat përbëjnë pjesë të trashëgimisë historike, kulturore dhe shoqërore të Kosovës, të përfshihen në listën e bashkësive që përfitojnë regjistrim të drejtpërdrejtë. Vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë neutrale, të paanshme dhe mbi baza të barabarta.
25. Në këtë kontekst, Komisioni i Venecias i kishte kushtuar vëmendje të veçantë Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës duke konsideruar se autoritetet e Kosovës duhet të shqyrtojnë me kujdes dhe në konsultim me përfaqësuesit e Tarikateve nëse kjo bashkësi plotëson kriterin e të qenit pjesë e trashëgimisë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit, në mënyrë që të përfshihet në listën e bashkësive që regjistrohen automatikisht.
26. Avokati i Popullit vlerëson se mos përfshirja e BKT-së në ligjin aktual si dhe kushtëzimi për regjistrim i përcaktuar me Projektligjin për ndryshimin e ligjit aktual, duhet të vlerësohet në dritën e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
27. Çfarë veçanërisht bie në sy nga analiza e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare, është neni Neni 6 [Liria e bashkimit fetar], i cili përcakton si në vijim:

³ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDD-AD\(2014\)012-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDD-AD(2014)012-e)

6.1. *Liria e bashkimit për qëllime fetare është e garantuar në bazë të ligjit në fuqi të Kosovës.*

6.2. *Ndalohet formimi i një shoqate fetare e cila për nga emri ose statuti sugjeron që është zyrtarisht e lidhur ose e njohur nga një Bashkësi fetare, por që nuk e ka pëlqimin e së njëjtës.*

28. Avokati i Popullit vlerëson se ky nen paraqet çështje me rëndësi për e njohjen dhe organizimin e bashkësive fetare. Avokati i Popullit konsideron se paragrafi 6.2 nuk duhet të interpretohet në kuptimin që një bashkësi fetare ekzistuese ka kompetencë të japë ose të refuzojë pëlqimin për themelimin e një organizimi tjetër fetar, vetëm për faktin se ky i fundit i përket të njëjtës traditë apo të një traditë të ngjashme fetare. Pëlqimi mund të jetë relevant për mbrojtjen e emrit, identitetit ose përkatësisë zyrtare të një bashkësie fetare, por nuk mund të shndërrohet në kusht për ushtrimin e së drejtës së një grupi tjetër për organizim autonom fetar. Një interpretim i tillë do të rrezikonte të kufizonte pluralizmin fetar dhe të binte ndesh me detyrimin e shtetit për neutralitet dhe paanshmëri.
29. Për të ofruar një qëndrim me të qartë lidhur me rastin në trajtim, Avokati i Popullit i referohet nenit 53 të Kushtetutës, i cili përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
30. Në aktgjykimin *Hasan and Chaush kundër Bullgarisë* (Dhoma e Madhe, nr. 30985/96, 26 tetor 2000), §§ 77-83, GjEDNj vlerësoi se, edhe pse nuk ishte e nevojshme të vendoste në mënyrë abstrakte nëse regjistrimi formal i bashkësive fetare përbën ndërhyrje në lirinë e fesë, autoritetet shtetërore kanë detyrim të ruajnë neutralitetin në çështjet fetare. Shteti nuk ka kompetencë të përcaktojë se cili udhëheqës ose cilat bindje fetare janë legjitime dhe nuk mund të favorizojë një fraksion të një bashkësie fetare ndaj një tjetri apo të imponojë një udhëheqje të vetme kundër vullnetit të anëtarëve të saj.
31. GjEDNj theksoi se veprimet e autoriteteve nuk ishin thjesht akte teknike regjistrimi, por ndërhyrje në organizimin e brendshëm të bashkësisë fetare, pasi ato favorizuan një fraksion duke e njohur si udhëheqjen e vetme zyrtare dhe përjashtuan plotësisht udhëheqjen tjetër nga përfaqësimi i besimtarëve. Si rrjedhojë, GjEDNj konstatoi se kishte ndërhyrje në të drejtën për lirinë e fesë të garantuar me nenin 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një ndërhyrje e tillë mund të konsiderohet e lejueshme vetëm nëse është e parashikuar me ligj, ndjek një qëllim legjitim dhe është e domosdoshme në një shoqëri demokratike.
32. Në rastin *Kisha Metropolitane e Besarabisë dhe të tjerë kundër Moldavisë* (nr. 45701/99, aktgjykim i 13 dhjetorit 2001, përfundimtar më 27 mars 2002), GjEDNj konstatoi shkelje të nenit 9 të Konventës. GjEDNj konstatoi se refuzimi i njohjes së Kishës aplikante përbënte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së fesë, pasi mungesa e njohjes e pengonte atë të funksiononte, të zhvillonte shërbesa fetare dhe të mblidheshin besimtarët e saj, ndërsa mungesa e personalitetit juridik e privonte nga mbrojtja gjyqësore e pasurisë së saj (§§105–106).
33. Në mënyrë të veçantë, GjEDNj theksoi se, në parim, neni 9 i KEDNj përjashton vlerësimin nga shteti të legjitimitetit të bindjeve fetare ose të mënyrave në të cilat ato shprehen. Masat shtetërore që favorizojnë një udhëheqës ose organe të caktuara të një bashkësie fetare të ndarë, ose që synojnë ta vendosin një pjesë të saj, kundër vullnetit të saj, nën një udhëheqje

të vetme, nuk janë në pajtim me lirinë e fesë (§117). Për më tepër, GjEDNj theksoi se duke qenë se bashkësitë fetare tradicionalisht ekzistojnë në formën e strukturave të organizuara, neni 9 duhet të interpretohet në dritën e nenit 11 [Liria e Tubimit dhe Organizimit] të KEDNj, i cili mbron jetën shoqërore dhe të drejtën e organizimit nga ndërhyrjet e pajustificuara të shtetit. Nga ky këndvështrim, e drejta e besimtarëve për lirinë e fesë, e cila përfshin edhe të drejtën për ta shfaqur fenë në bashkësi me të tjerët, nënkupton pritshmërinë që besimtarëve t'u lejohet të bashkohen dhe të organizohen lirisht, pa ndërhyrje arbitrare të shtetit. Në të vërtetë, ekzistenca autonome e bashkësive fetare është e domosdoshme për pluralizmin në një shoqëri demokratike dhe, për rrjedhojë, përbën një çështje që qëndron në thelb të mbrojtjes që ofron neni 9 i Konventës (shih Hasan dhe Chaush, cituar më lart, § 62). (§118).

34. Këto parime duhet të lexohen së bashku me njohjen nga GjEDNj-ja të së drejtës së shtetit për të verifikuar nëse një lëvizje ose shoqatë, duke vepruar në dukje për qëllime fetare, zhvillon veprimtari që janë të dëmshme për popullsinë ose për sigurinë publike (§§111–113). Në këtë kuptim, mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike mund të përbëjë një qëllim legjitim për ndërhyrjen e shtetit sipas nenit 9 §2 të KEDNj-së. Megjithatë, një ndërhyrje e tillë duhet të jetë e “parashikuar me ligj”, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë e domosdoshme në një shoqëri demokratike (§106), ndërsa baza ligjore duhet të jetë mjaftueshëm e qasshme dhe e parashikueshme dhe të ofrojë garanci të përshtatshme kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike (§109). Rrjedhimisht, shteti nuk mund të ndërhyjë mbi bazën e vlerësimit të legjitimitetit të bindjeve fetare ose të mënyrave në të cilat ato shprehen, por ka të drejtë të shqyrtojë veprimtaritë konkrete të një lëvizjeje ose shoqate që paraqitet si fetare dhe kur plotësohen kushtet e nenit 9 §2, të marrë masa për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.
35. Në rastin *İzzettin Doğan dhe të tjerë kundër Turqisë* (Dhoma e Madhe, nr. 62649/10, 26 prill 2016), çështja lidhej me refuzimin e autoriteteve turke për t'u ofruar ndjekësve të besimit Alevi shërbime fetare publike të krahasueshme me ato që u ofroheshin ndjekësve të interpretimit sunit të Islamit. Kërkesat e aplikantëve përfshinin, ndër të tjera, njohjen e udhëheqësve të tyre fetarë, njohjen e vendeve të adhurimit dhe mbështetjen financiare të komunitetit. GjEDNj-ja konstatoi se refuzimi i autoriteteve për t'i trajtuar këto kërkesa kishte pasoja konkrete për organizimin, vazhdimësinë dhe financimin e veprimtarisë fetare të komunitetit Alevi dhe, në rrethana të rastit, përbënte ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së fesë. GjEDNj theksoi se autoritetet nuk mund të mohojnë natyrën fetare të një komuniteti ose të praktikave të tij duke e klasifikuar atë vetëm sipas një interpretimi të caktuar të fesë; përkundrazi, në ushtrimin e kompetencave të tyre në fushën e fesë, shtetet duhet të ruajnë neutralitetin dhe paanshmërinë ndaj bindjeve dhe organizimeve të ndryshme fetare. GjEDNj-ja vlerësoi se besimi Alevi kishte karakteristika të rëndësishme që e dallonin nga interpretimi i Islamit të ndjekur nga Departamenti i Çështjeve Fetare dhe se arsyet e paraqitura nga shteti për justifikimin e kësaj qasjeje nuk ishin relevante dhe të mjaftueshme në një shoqëri demokratike.
36. GjEDNj-ja konstatoi gjithashtu komunitetit Alevi i ishte bërë një dallim në trajtim krahasuar me interpretimin sunit të Islamit, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, duke gjetur shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 9 (§§160, 165). Në vlerësimin e saj, GjEDNj-ja i kushtoi rëndësi faktit se komuniteti Alevi ishte pothuajse tërësisht i përjashtuar nga shërbimi publik fetar dhe, në të njëjtën kohë, ishte përfshirë në

regjimin juridik që zbatohej ndaj urdhrave sufi (*tarikati*), të cilët i nënshtroheshin ndalimeve të rëndësishme. Kjo situatë krijonte një pabarazi të theksuar ndërmjet statusit të komunitetit që përfitonte nga shërbimi publik fetar dhe komunitetit Alevi.

37. Në një kontekst veçanërisht të afërt me çështjen që trajtohet nga Avokati i Popullit, GjEDNj-ja është shprehur edhe në rastin *Komuniteti Bektashi dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (nr. 48044/10, 75722/12 dhe 25176/13, 12 prill 2018). Çështja kishte të bënte me një komunitet bektashi që kishte funksionuar si organizatë fetare e njohur që nga viti 1993, por pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri në vitin 2007, gjykatat vendore refuzuan të pranenin vazhdimin e statusit të tij dhe kërkesën e re për regjistrim. Ky rast është me rëndësi të veçantë për vlerësimin e situatës së Tarikateve, pasi tregon se çështja e statusit juridik të një organizimi fetar nuk mund të trajtohet vetëm si çështje formale e regjistrimit. GjEDNj-ja e ka vendosur këtë çështje në kuadrin e nenit 9 dhe të së drejtës së komuniteteve fetare për organizim dhe ushtrim kolektiv të besimit. Në këtë kuptim, një procedurë shtetërore për njohje ose regjistrim duhet të respektojë kërkesat e ligjshmërisë, parashikueshmërisë, neutralitetit dhe proporcionalitetit dhe nuk duhet të krijojë pengesa arbitrare për funksionimin e një organizimi fetar.
38. E përbashkëta e rasteve të sipërpërmendura të GjEDNj-së është se njohja dhe regjistrimi i bashkësive fetare nuk mund të trajtohen si procedura thjesht formale administrative. Ato lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin kolektiv të lirisë së fesë të garantuar me nenin 9 të KEDNj-së. Shteti gëzon një hapësirë për të rregulluar procedurat e njohjes dhe regjistrimit dhe për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore, por gjatë ushtrimit të kësaj kompetence duhet të ruajë neutralitetin dhe paanshmërinë ndaj bindjeve dhe organizimeve të ndryshme fetare. Shteti nuk mund të vlerësojë se cila bindje është legjitime ose cila formë e organizimit fetar është më e pranueshme, as të favorizojë një grup fetar kundrejt një tjetri pa një arsyetim objektiv, të ligjshëm dhe proporcional. Refuzimi ose pengimi i njohjes, kur ka pasoja reale për funksionimin dhe ushtrimin kolektiv të fesë, mund të përbëjë ndërhyrje në nenin 9 dhe, në rast të trajtimit të pabarabartë, të ngrejë edhe çështje sipas nenit 14 në lidhje me nenin 9 të Konventës.
39. Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e personalitetit juridik të BTK, ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në deklarimin e përkatësisë fetare në formularët për regjistrimin e popullsisë të vitit 2024. Pasojat e mosnjohjes së ndonjë bashkësie fetare *kanë ndikim jo vetëm në në të drejtat ligjore, por edhe në stimuj financiarë dhe se dështimi për të fituar një status të preferuar regjistrimi mund të pengojë rritjen apo edhe mbijetesën e një grupi*.⁴
40. Në anën tjetër, as bashkësitë tjera fetare nuk gëzojnë personalitet juridik, por ato ligji i njeh shprehimisht dhe si rezultat këto bashkësi gëzojnë lehtësira në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre, në mes tjerash edhe deklarimi përkatësisë në formularët e regjistrimit të popullsisë.
41. Kur bëhet fjalë të deklarimi, Avokati i Popullit sjellë në vëmendje të drejtën e Vetë-identifikimit, e cila mbrohet nga Neni 36 i Kushtetutës [E Drejta e Privatësisë] dhe Neni 8 i Konventës [E Drejta e Respektimit të Jetës Private dhe Familjare]; Neni 24 i Kushtetutës [Barazia para Ligjit] dhe Neni 14 i Konventës [Ndalimi i diskriminimit] dhe Neni 1 i

⁴ JOURNAL FOR THE SCIENTIFIC STUDY OF RELIGION - Assessing the Impact of Religious Registration https://www.researchgate.net/publication/325063455_Assessing_the_Impact_of_Religious_Registration_IMPACT_OF_RELIGIOUS_REGISTRATION

42. GjEDNJ,⁵ konsideron se e drejta për vetëidentifikim të lirë është një e drejtë me rëndësi thelbësore në mbrojtjen e grupeve minoritare, duke përfshirë si minoritetet etnike ashtu edhe ato fetare. Për më tepër, e drejta për vetëidentifikim të lirë nuk është një e drejtë specifike për Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës. Ajo është "gurthemeli" i të drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e pakicave në përgjithësi (*Molla Sali kundër Greqisë* [GC], 2018, § 157; *Tasev kundër Maqedonisë së Veriut*, 2019, § 33; *Sagir dhe të tjerë kundër Greqisë*, 2025, § 50).

Konstatime


1. Avokati i Popullit vlerëson se, pavarësisht paqartësive të Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare, ai nuk përjashton ekzistencën e bashkësive të tjera fetare në Republikën e Kosovës, të cilat gëzojnë mbrojtjen dhe të drejtat e garantuara me ligj. Avokati i Popullit duke u bazuar edhe në jurisprudencën e GjEDNJ thekson se shteti nuk mund të mohojë karakterin fetar të një komuniteti ose ta trajtojë atë më pak favorshëm për shkak të interpretimit të ndryshëm fetar.
2. Avokati i Popullit vlerëson se formulimi i pyetjes për përkatësinë fetare në formularin e Regjistrimit të Popullsisë 2024 nuk garanton plotësisht të drejtën për vetëidentifikim fetar dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë pluralizmin fetar në Kosovë.
3. Përfshirja vetëm e tri besimeve fetare në formular, ndërsa të gjitha besimet e tjera grupohen në kategorinë "Tjetër" pa u paraqitur veçmas në rezultatet statistikore, krijon trajtim të pabarabartë dhe kufizon dukshmërinë institucionale të bashkësive të tjera fetare, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së barabartë të garantuar nga Ligji për Lirinë Fetare.
4. Mungesa e një mekanizmi efektiv për regjistrimin dhe fitimin e personalitetit juridik të bashkësive fetare, vazhdon të krijojë pasoja praktike dhe juridike. Në përputhje me praktikën e GjEDNJ-së, shteti ka detyrim të sigurojë neutralitet, paanshmëri dhe procedura regjistrimi që nuk krijojnë pengesa apo trajtim diskriminues.

Qëndrimet e Avokatit të Popullit

1. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i propozojë Kuvendit miratimin e një kuadri ligjor për regjistrimin dhe statusin juridik të bashkësive fetare, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudencën e GjEDNJ-së dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias.
2. Gjatë hartimit të legjislacionit të ri, Qeveria dhe Kuvendi të sigurojnë që kriteret për regjistrimin e bashkësive fetare të jenë objektive, proporcionale, transparente dhe jodiskriminuese, pa krijuar privilegje ose pengesa të pajustificuara.
3. Qeveria, në konsultim me Bashkësinë e Tarikateve të Kosovës dhe bashkësitë e tjera relevante, të shqyrtojë statusin e tyre në përputhje me standardet e Komisionit të Venecias dhe të GjEDNJ-së, me qëllim garantimin e trajtimit të barabartë.
4. Në proceset e ardhshme të hartimit të politikave publike dhe mbledhjes së të dhënave statistikore mbi përkatësinë fetare, institucionet publike të garantojnë respektimin e së drejtës për vetëidentifikim, barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit, në përputhje

⁵ https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_minority_rights_eng fq 11/17

statistikore mbi përkatësinë fetare, institucionet publike të garantojnë respektimin e së drejtës për vetëidentifikim, barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Me nderime,
Naim Qelaj

Avokat i Popullit